



KUVENDI I SHQIPËRISË
KRYETARI

Nr. 811/116 Prot.

Tiranë më 12, 04, 2017

Lënda: Njoftimi i mbledhjes së seancës plenare për krijimin dhe përbërjen e dy komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve dhe kërkesa për propozimin për përbërjen e këtyre komisioneve *ad hoc*, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Drejtuar:

Zotit: Gramoz RUÇI
Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Zotit: Edi PALOKA
Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike

Zotit: Luan RAMA
Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim

Zonjës: Mesila DODA
Kryetare e Grupit Parlamentar të Partisë për Drejtësi, Integrim, Unitet

Zotit: Fatmir MEDIU
Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane

Këtu

Bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Avokati i Popullit me shkresën nr. 104 Prot, datë 7.4.2017, ka dërguar listën e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret formale, listën e kandidatëve, të cilët nuk i plotësojnë kriteret formale, dhe listën e rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për institucionet e rivlerësimit, si dhe dosjet e secilit kandidat, marrja në dorëzim e të cilave prej përfaqësueve të shërbimeve të Kuvendit ka përfunduar më datë 8.04.2017.

Në zbatim të nenit 9, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” njoftoj mbledhjen e seancës plenare **ditën e martë, datë 18.04.2017, ora 18.00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i projektvendimit të Kuvendit “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit *ad hoc* me 12 anëtarë, të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Miratimi i projektvendimit të Kuvendit “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit *ad hoc* me 6 anëtarë, të përzgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Këto komisione përbëhen respektivisht nga:

- a) 12 anëtarë, gjashtë të propozuar nga grupet parlamentare të shumicës dhe gjashtë nga grupet parlamentare të pakicës;
- b) 6 anëtarë, tre të propozuar nga grupet parlamentare të shumicës dhe tre nga grupet parlamentare të pakicës.

Sjell në vëmendjen Tuaj përcaktimin e nenit 9, pika 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehet:

“3. Një deputet mund të jetë anëtar vetëm në njërin nga komisionet ad hoc të përzgjedhjes. Anëtarët e komisionit ad hoc të verifikimit të kandidatëve nuk kanë pengesë për të qenë edhe anëtarë në një nga komisionet ad hoc të përzgjedhjes.”

Sa më sipër, Ju lutem, **brenda datës 13 prill, ora 16.00** dërgoni propozimet Tuaja për përbërjen e komisioneve *ad hoc* të përzgjedhjes së kandidatëve.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI

Ilir META

